

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Tiranë më 20.01.2020

OPINION

Lidhur me qëndrimin tim pjesërisht kundër Vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë datë 20.01.2020!

Në vazhdimësinë e problemeve të ngritura herë pas here nga disa Anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përfshi edhe mua, tashmë të bëra edhe publike, e njëjta situatë riciklohet pothuaj në çdo seancë plenare me gjithë kërkesat e njëpasnjëshme për mosrespektim procedure, dhe e kontestuar në vazhdimësi. Në këto kushte dhe ripërsëritjes së të njëjtit problem, unë vendosa sot të dalë me opinion pjesërisht kundër.

Konkretisht kundër disa vendimeve të datës së sotme, lidhur me relacionet për verifikimin e pasuirsë, figurës, integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të 10 kandidaturëve për tu emëruar magjistrat prokuror. Dua të theksoj se nuk kam asnjë objeksion lidhur me 10 kandidaturat, përkundrazi i motivoj në misionin e tyre fisnik, por ky opinion lidhet me shkeljet ligjore të konstatuara nga ana ime dhe në mënyrë të përsëritur nga Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Gent Ibrahimi me argumentin si më poshtë vijon: Neni 164 i Ligjit Nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", citon:

Thirrja e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë

164/5. Kryetari siguron respektimin e procedurave për njoftimin me shkrim të çdo anëtari jo më vonë se 7 ditë përpara çdo mbledhjeje të Këshillit.

164/6. Njoftimi shoqërohet me rendin e ditës, projektvendimet që propozohet të merren gjatë mbledhjes, së bashku me çdo të dhënë, projektakt, këshillë ligjore, si dhe çdo informacion apo dokument tjetër, i cili do të merret në shqyrtim në mbledhje, apo i cili i shërben diskutimeve në mbledhje.

Mungesa e verifikimit të çdo akti të ardhur nga institucionet shtetërore dhe sidomos ato ligjzatuese, dhe privimi për ti studiuar ato, na detyron të mos respektojmë verdiktin e shumicës dhe për rrjedhojë, na privon të shprehemi.

Ky shqetësim, jo vetëm që është bërë disa herë problem, madje duke shtyrë edhe mbledhjet plenare, por përsëri nga ana e Kryetarit të Këshillit nuk respektohet kjo dispozitë ligjore, çka na detyron të dalim kundër votimit.

Një fakt të tillë do ta ripërsërisë deri në futjen në binarët e procedurës dhe të ligjit.

Ky opinion kërkoj ti bashkëngjitet çdo vendimi respektiv.

KËSHILLI I LARTË TË PROKURORISË

ANËTAR

TARTAR BAZAJ

